



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

RAPORT

PËR VETEVALUIM TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE

Tetovë, 2021

Fakulteti i Kulturës Fizike-Факултет за физичка култура-Faculty of Physical Education

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: pe@unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT	3
2.1. Historiku.....	3
2.2. Misioni	6
3. VEPRITMARTA MËSIMORE DHE SHKENCORE NË FAKULTETIN E KULTURËS FIZIKE.....	7
3.1. Struktura e kuadrit mësimor.....	7
3.2. Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit të Kulturës Fizike	9
4. STRUKTURA E STUDENTËVE	11
4.1. Promovimi i Fakultetit	11
4.2. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	12
4.3. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike	12
5. VEPRITMARTA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE	13
6. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE	20
7. SWOT ANALIZA.....	22
8. KONKLUDIMI.....	23

1. HYRJE

Qëllimi i vetevaluimit i realizuar për vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 është të identifkohet gjendja momentale e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe përfundimet nga i njëjti të shërbejnë si bazë e mbindërtimit të kualitetit të procesit mësimor-shkencor, edhe atë si në studimet deridiplomike edhe në ato pasdiplomike. Evaluimi i brendshëm u realizua nga komisioni për vetevaluim i Fakultetit të Kulturës Fizike. Në proces të evaluimit u përfshinë:

- Vlerësimi i programeve studimore ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore;
- Struktura e kuadrit mësimor-shkencor;
- Përshkrimi i realizimit të mësimdhënies;
- Vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor;
- Studentët- struktura dhe anketimi i studentëve;
- Struktura e kuadrit administrativ dhe teknik;
- Hapësirat dhe mjetet e realizimit të procesit mësimor.

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit nuk ka pasur ndonjë vështirësi. Në vazhdimësi kanë ndihmuar të gjithë profesorët, bashkëpunëtorët dhe studentët, të cilët kanë qenë të kyçur në forma të ndryshme me qëllim që ky proces të realizohet me sukses.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti i Kulturës Fizike është institucion i lartë arsimor në kuadër të Universitetit të Tetovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjeneza e të cilit filloi më 16 gusht 1996, dy vjet pas themelimit të Universitetit Shtetëror të Tetovës -1994. Pas zyrtarizmit të UT-së në vitin 2004, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Arteve u themelua edhe

3

Fakulteti i Kulturës Fizike-Факултет за физичка култура-Faculty of Physical Education

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: pe@unite.edu.mk

programi studimor për Kulturë Fizike në vitin akademik 2004/05, ndërsa më vitin 2007 ky program studimor u transformua në Fakultet të Kulturës Fizike. Nga viti 2004 në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike funksionon edhe Qendra e Edukimit Fizik e cila realizon mësimin në sferën e edukimit fizik dhe aktiviteteve sportive në të gjitha fakultetet e Universitetit të Tetovës. Fakulteti i Kulturës Fizike bashkëpunon edhe me shumë universitete tjera nga rajoni dhe Evropa. Nga viti 2008 filloi bashkëpunimi në projektin e përbashkët Tempus Joint për harmonizimin e programeve mësimore ndërmjet fakulteteve të kulturës fizike të Tiranës, Tetovës dhe Prishtinës me perspektivë të BE. Partnerë në realizimin e projektit janë Universiteti Foro Italico nga Italia, Universiteti i Vjenës, Universiteti Jugor i Danimarkës, Shkolla Norvegjeze e Shkencave Sportive, Universiteti për Sport i Gjermanisë në Këln, Universiteti i Maltës, Universiteti Poitiers i Francës, Universiteti Bristoll në Angli, Universiteti Groningen i Holandës, Universiteti i Athinës në Greqi, Universiteti Carnegie në Angli dhe Universiteti Xhustus-Libe në Gjermani. Gjithashtu, Fakulteti i Kulturës Fizike kontakton dhe bashkëpunon edhe me fakultete të ngjashme nga vendet fqinje e më gjerë, ku mund të veçohet shkolla e lartë e teknologjisë sportive Haxhetepe-Ankara nga R. e Turqisë.

Studentët si dhe mësimdhënësit e Fakultetit të Kulturës Fizike gjatë viteve akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 kanë qenë pjesëmarrës aktiv në kampionate, manifestime si dhe gara të ndryshme sportive në vend, rajon e më gjerë.

Fakulteti i Kulturës Fizike gjatë kësaj periudhe kohore ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete tjera, gjegjësisht fakultete të fushës së edukimit fizik dhe shëndetësor, edhe atë me Kolegjin AAB - institucion jopublik i arsimit të lartë në Kosovë, Fakultetin e Sportit dhe Edukimit Fizik në kuadër të Universitetit të Malit të zi – Nikshiq, si dhe me Fakultetin e Kineziologjisë në kuadër të Universitetit të Zagrebit.

Për nder të festës kushtuar përvjetorit të themelimit të UT- së Fakulteti i Kulturës Fizike në bashkëpunim me UT-në ka organizuar aktivitete sportive në futboll të vogël, basketboll, volejball, volejball plazhi dhe shah, pjesëmarrës të të cilave kanë qenë studentë nga të gjitha fakultetet e UT-së.

Krenaria e Fakultetit të Kulturës Fizike janë sukseset e arritura të studentëve të cilët janë

kalitur pikërisht në fakultetin tonë. Numri i të diplomuarve në Fakultetin e Kulturës Fizike për vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 është 97. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë arritur suksese të larta në sporte të ndryshme në kampionate vendore dhe të jashtme si në sportin e futbollit, sporteve luftarake (mundje, xhudo, karate), në skijim, volejboll, atletikë etj. Vlen të potencohet se disa nga këta sportistë janë pjesëmarrës edhe në kampionate botërore dhe olimpike (si për shembull Shaban Tërstena-kampion olimpiq në mundje, Berat Jakupi kampion i trefishtë evropian dhe një herë kampion botëror për senior, Agim Ibraimi- futbollist, Dardan Dehari skijator në kampionatin botëror) etj.

Sot, Fakulteti i Kulturës Fizike realizon veprimtarinë e tij mësimore-shkencore në përputhshmëri me Sistemin e Akumulimit dhe Transferimit të Kredive (ECTS), që mundëson realizimin e veprimtarisë së tij sipas standardeve evropiane bashkëkohore.

Studimet Bachelor- programi tetë semestral i Fakultetit të Kulturës Fizike u mundëson studentëve njohuri të domosdoshme për zotërimin e shkencave sportive si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, për inkuadrimin në tregun e punës ose për vazhdimin e studimeve master. Titulli që fitohet me mbarimin e studimeve është: *profesor i diplomuar i edukimit fizik dhe shëndetësor*. Fakulteti i Kulturës Fizike është në funksion të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik për ciklin e shkollimit 9-vjeçar dhe shkollimit të mesëm si dhe specialistëve të sportit - trajner sportiv.

Studimet e ciklit të dytë – Studimet master ofrojnë gjithnjë e më shumë trajnime praktike, të cilat shkojnë përtej njohurive të përgjithshme, duke mundësuar aftësim cilësor në fushat përkatëse të interesit. Ato i sjellin studentët më afër kërkimit shkencor, duke zhvilluar aftësitë interpretuese të nevojshme për zgjidhjen e problemeve në zbatimin e shkencave sportive në këto drejtime studimore:

- edukim fizik
- shkenca sportive
- menaxhment sportiv dhe rekreacion

Studimet e doktoraturës – Në vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019, Fakulteti i Kulturës Fizike ka ofruar mundësi të thellimit të njohurive dhe

specializimit, me qëllim parësor nxitjen e kërkimeve dhe të studimeve në fushën e kineziologjisë. Me mbarimin e studimeve të doktoraturës studentët marrin titullin *doktor i kineziologjisë* në drejtimet:

- Hulumtime në kineziologjinë fundamentale;
- Hulumtime në kineziologjinë shoqërore;
- Hulumtime në kineziologjinë aplikative.

2.2. Misioni

Fakulteti i Kulturës Fizike ka mision të rëndësishëm si në aspektin akademik edhe në atë shkencor. Misioni i Fakultetit të Kulturës Fizike është i orientuar në përgatitjen e kuadrit të aftë të mësimdhënësve të sportit të cilët do të stimulojnë praktikimin e sportit te gjeneratat e reja. Por, mision jo më pak i rëndësishëm është edhe krijimi i kuadrit të specialistëve të sportit, që do të lënë gjurmë në fushat e ndryshme sportive.

Fakulteti i Kulturës Fizike është përkushtuar fuqishëm drejt vizionit për përgatitje të kuadrit të mësimdhënësve kompetentë dhe profesionalë të cilët do të arsimojnë, edukojnë dhe do të nxjerrin kadro të reja me kapacitet profesional.

Struktura udhëheqëse e Fakultetit të Kulturës Fizike përbëhet nga dekani, dy prodekanë dhe një koordinator. Raportet në mes të organeve udhëheqëse, stafit mësimdhënës dhe administratës janë në nivel të dëshiruar.

Zhvillimi i planit strategjik në Fakultetin e Kulturës Fizike qëndron në tërësinë e sistemit të tij. E veçantë në planin strategjik është mënyra e realizimit të qëllimeve të caktuara p.sh.: organizimi dhe administrimi i punës, organizimi dhe realizimi i punës profesionale si dhe përgatitja e kuadrit profesional. Plani strategjik i fakultetit po ashtu është i lidhur edhe me akreditimin e programeve të reja dhe zbatimin e tyre, aktivitetet kërkimore të fakultetit duke planifikuar dhe publikuar punime me cilësi të lartë shkencore, aktivitete për t'u kyçur në projekte ndërkombëtare për përmirësimin e cilësisë shkencore.

3. VEPRTIMTARIA MËSIMORE DHE SHKENCORE NË FAKULTETIN E KULTURËS FIZIKE

3.1. Struktura e kuadrit mësimor

Procesi mësimor në Fakultetin e Kulturës Fizike realizohet me mësim teorik, praktik, laboratorik dhe mësim të aktiviteteve në terren. Realizimi i ligjëratave dhe ushtrimeve në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike rrjedh sipas dinamikës së paraparë në programin e Fakultetit. Mësimi teorik, praktik si dhe mësimi laboratorik realizohet në objektet e Fakultetit të Kulturës Fizike, ndërsa mësimi i aktiviteteve në terren, për shkak të karakteristikave lëndore realizohet në sallën sportive dhe terrenet e hapura në UT. Sporti i notit realizohet në pishinën olimpikë në Shkup, skijimi në Kodrën e Diellit, aktivitetet rekreative dhe turizmi realizohen në kampet e llogorit, bjeshkëtarisë dhe alpinizmit, kurse praktika pedagogjike realizohet në shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme.

Në Fakultetin e Kulturës Fizike procesin mësimor e realizojnë gjithsej 20 mësimdhënës (tabela 1 dhe 2). Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin e Kulturës Fizike realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës. Gjithsej janë të punësuar 18 mësimdhënës dhe 2 bashkëpunëtorë, me moshë mesatare 48,38 respektivisht 33 për bashkëpunëtorët. Proporcioni i mësimdhënësve me studentët është 10.83, respektivisht 97.2, që nënkupton se një profesori i takon të punojë me 10.83 kurse një asistenti me 97.2 studentë. Nëse marrim parasysh edhe angazhimin e mësimdhënësve me kontratë atëherë arrin sadopak të balancohet numri studentëve që udhëhiqen nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët që mundëson me sukses realizimin e mësimin sipas ECTS.

Tabela 1. Struktura e mësimdhënësve në Fakultetin e Kulturës Fizike

Të rregullt		Mosha	Totali	Me kontratë		Mosha	Gjithsej

Ordinar	6	55.1	6	Inordinar	/	/	/
Inordinar	6	49	6	Ordinar	/	/	/
	12	52.05	12		/	/	/
Docent	6	40.5	6	Docent	1	37	1
	18		18	/	1	/	1
Gjithsej		48.2			1	37	2

Tabela 2. Struktura e bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Kulturës Fizike

Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Mosha	Gjithsej
Asistent	2	/	33	2	Asistent	/	/	/
Gjithsej	2	/	/	2	Gjithsej	/	/	/

Për mbarëvajtjen e çështjeve administrative në Fakultetin e Kulturës Fizike janë angazhuar gjithsej 7 persona dhe të gjithë janë me përgatitje të lartë arsimore. Mbarëvajtjen e pjesës teknike në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike e azhurnon një punëtor.

Tabela 3. Struktura e kuadrit administrativ në Fakultetin e Kulturës Fizike.

Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Gjithsej
Arsim i lartë	5	2	7	Arsim i lartë	1	1
Arsim i mesëm	/	/	/	Arsim i mesëm	/	/
Gjithsej	5	2	7	Gjithsej	1	1

3.2. Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit të

Kulturës Fizike

Në Fakultetin e Kulturës Fizike për vlerësimin e realizimit të orës nga studentët janë plotësuar 239 pyetësorë. Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike deklarojnë se ora fillon saktë sipas orarit të paraparë rreth (97% e përgjigjeve) kurse rreth (91% e përgjigjeve) se ora mbaron në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Gjatë ligjërimit mësimdhënësit kryesisht kanë përdorur power point prezantime (mbi 75%) kurse (rreth 15%) deklarojnë se gjatë realizimit të ligjëratës mësimdhënësit shënojnë në tabelë. Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike deklarojnë se gjatë ligjëratave nuk bëjnë pauzë (rreth 93%).

Realizimi i ligjëratave

Studentët kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme kanë qenë prej 1 (aspak nuk pajtohem) deri në 5 (plotësisht pajtohem). Në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës gjatë ligjëratave. Mësimdhënësi është i sigurt gjatë ligjërimit ($M=4.71$), bindës ($M=4.64$) si dhe i qartë ($M=4.57$) janë karakteristika me vlerësime më pozitive në kategorinë e evaluimit të realizimit të orës gjatë ligjëratave.

Tabela 4. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

	Tema në përputhshmëri me ligjëratat	Ligjëratat të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
Kulturë Fizike	4.08 (239)	4.57 (239)	4.71 (239)	4.64 (239)

Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve në të cilat studentët janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët vlerësojnë se në fillim të orës u është prezantuar tema që e

trajtojnë gjatë ligjëratis (4.58) si dhe mësimdhënësit pyesin për paqartësitë eventuale në lidhje me temën e ligjëruar (M=4.60) si dhe orientimi në pikat kyçe të temës (M=4.13). Për qartësinë e ligjërimit është tregues edhe pohimi i vlerësuar pozitivisht se studentët e kanë të qartë në çka duhet të fokusohen për të mësuar nga tema e trajtuar në ligjëratis e caktuar (M=4.42).

Tabela 5. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së ligjëratis

	Orientim në pikat kyçe të temës	Lidhshmëri me tema tjera	Ilustrim i përmbajtjes me shembuj	Lidhshmëri për përdorim të njohurive në praktikë	Motivon për pjesëmarrje aktive në ligjëratis
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
Kulturë	4.13 (239)	3.76 (239)	4.22 (239)	3.88 (239)	4.22 (239)
Fizike					

Menaxhimi i orës është vlerësuar nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme në të gjitha pohimet kanë lëvizur prej opsionit aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët në nivel të fakultetit japin vlerësime pozitive në pyetjet në lidhje me menaxhimin e orës gjatë ligjëratis. Menaxhimi efektiv i orës ka kontribuar që studentët të japin vlerësim më pozitiv për dukurinë se gjatë orës kanë qenë të koncentruar (M=4.37). Qasja e mësimdhënësit ndaj studentëve si për të stimuluar gjithë studentët për pjesëmarrje aktive në ligjëratis (M=3.11) si dhe menaxhimi i diskutimit me studentë ku mësimdhënësi është i paanshëm dhe lë hapësirë për gjithë studentët për diskutim (M=3.85).

Interaksionin joverbal të mësimdhënësve studentët e kanë vlerësuar nëpërmjet dhjetë pohimeve, gjithashtu me pesë opsione të mundshme për përgjigje edhe atë prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Në tërësi studentët vlerësojnë pozitivisht interaksionin e mësimdhënësve ndaj tyre gjatë realizimit të ligjëratis. Kontakti joverbal me të gjithë studentët si vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve është karakteristikë e veçuar pozitive e mësimdhënësve (M=4.43). Orientimi i shikimit të mësimdhënësit si fiks në hapësirë (M=2.06)

ose në mjetin që ka përdorur për prezantim (M=2.65) janë dukuritë të cilat kanë më shumë hapësirë për t'u avancuar sipas vlerësimit nga studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike.

Megjithatë, në përgjithësi studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike vlerësojnë se janë të kënaqur me mënyrën e organizimit të ligjëratave (M=4.57).

Tabela 6. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së menaxhimit të orës nga mësimdhënësi

	Dëgjoi në mënyrë aktive komentet e studentëve	Stimuloi për pjesëmarrje aktive në ligjëratë	Ishte i paanshëm gjatë diskutimit të studentëve	Mbajti koncentrimin e studentëve	Vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve	Të kënaqur nga realizimi i orës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
Kulturë Fizike	3.63 (239)	3.11 (239)	3.85 (239)	4.37 (239)	4.43 (239)	4.57 (239)

4. STRUKTURA E STUDENTËVE

4.1. Promovimi i Fakultetit

Oferta promovuese e Fakultetit të Kulturës Fizike bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Ky proces realizohet gjatë muajit prill dhe në kuadër të një komisioni prej disa anëtarësh realizohet vizitë nëpër të gjitha shkollat e mesme të R. Maqedonisë së Veriut si dhe disa shkollave të mesme në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi. Qëllimi i këtyre vizitave është parashtrimi i ofertës akademike dhe të gjitha kushteve cilësore që ofron Universiteti i Tetovës.

Përpos tjerash, promovimi i Fakultetit të Kulturës Fizike realizohet edhe në kuadër të ditëve të hapura që mbahen në oborrin e Universitetit, me çka ofrohen materiale të ndryshme promovuese. Me këtë rast organizohen edhe aktivitete të ndryshme sportive në terrene të hapura që tregojnë

rëndësinë e studimit të programeve studimore të Fakultetit të Kulturës Fizike. Gjithsesi promovimi vazhdon deri në mbyllje të afatit të regjistrimit të studentëve, edhe përmes faqes zyrtare të internetit www.unite.edu.mk; www.unitesport.edu.mk.

4.2. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 për katër vite të studimit është 284, (264 meshkuj dhe 20 femra) dhe siç shihet nga këto të dhëna vetëm 7% prej numrit të përgjithshëm të studentëve i takojnë gjinisë femërore. Kjo do të thotë se kultura fizike edhe më tej perceptohet nën prizmin e normave shoqërore respektivisht si profesion i cili i "takon" gjinisë mashkullore. Për më tej, rreth 3.1% e studentëve në këtë fakultet vijnë prej shteteve tjera, siç janë: Kosova, Mali Zi, Shqipëria dhe Turqia. Karakteristikë tjetër e dukshme nga tabela 4 është se numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë është dukshëm më i vogël se vitet vijuese të studimeve.

Sa i përket numrit të të diplomuarve në Fakultetin për Kulturë Fizike në studimet deridiplomike është si më poshtë: Në vitin akademik 2016/2017 kanë diplomuar 36 studentë, 5 femra dhe 31 meshkuj, nga këta 6 janë shtetas të huaj. Në vitin akademik 2017/2018 kanë diplomuar 14 studentë, 3 femra dhe 11 meshkuj, nga të cilët vetëm 1 është shtetas i huaj. Në vitin 2018/2019 gjithsej kanë diplomuar 47 studentë, 5 femra dhe 42 meshkuj nga të cilët 2 shtetas të huaj. Pra gjithsej brenda këtyre tre viteve kanë diplomuar 97 studentë nga të cilët 13 femra, 84 meshkuj- (9 shtetas të huaj).

Në drejtimin Sport, në vitin 2017 janë regjistruar gjithsej 12 studentë (të gjithë meshkuj). Në vitin 2018 janë regjistruar 22 studentë (të gjithë meshkuj). Në vitin 2019 janë regjistruar 14 studentë (të gjithë meshkuj).

4.3. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike

Në studime pasdiplomike për vitin akademik 2016/2017, gjithsej janë regjistruar 9 studentë, 5 prej të cilëve janë shtetas të huaj kurse prej numrit të përgjithshëm një i takon gjinisë

femërore. Për vitin akademik 2017/2018, në studimet master, gjithsej janë regjistruar 10 studentë, 9 prej të cilëve janë shtetas të huaj. Në vitin akademik 2018/2019, në studimet master, gjithsej janë regjistruar 10 studentë, 1 prej të cilëve është shtetas i huaj. Në studimet e doktoraturës për vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 nuk është regjistruar asnjë student. Të diplomuar në vitet akademike 2016/19, janë 97 studentë. Në ciklin e dytë (master) 7 të diplomuar dhe në ciklin e tretë (doktoraturë) 1 i diplomuar.

Tabela 7. Numri i studentëve në studime master, në vitin akademik 2017/19

	Viti i studimeve	Rregullt		Korrespondencë		Shtetas		Të diplomuar		Gjithsej
		M	F	M	F	Të huaj	Të vendit	Shtetas të huaj	Të vendit	
1	I (2016/2017)	9	1	8	/	5	4	1	2	3
2	I (2017/2018)	10	/	/	/	9	1	/	/	/
3	I (2018/2019)	10	/	/	/	1	9	4	/	4
	Gjithsej	29	/	/	/	15	14	5	2	7

5. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË

PROJEKTE

Konferencat shkencore që kuadri i Fakultetit të kulturës fizike ka marrë pjesë gjatë viteve akademike 2016-2019 janë si vijon:

- International Balkan Conference in Sport Sciences – IBCSS, University of Tetova, Faculty of Physical Education, Tetova **2016**.
- International Balkan Conference in Sport Sciences – IBCSS, University of Tetova, Faculty of Physical Education, Tetova **2017**.
- International Balkan Conference in Sport Sciences – IBCSS, University of Tetova, Faculty of Physical Education, Tetova **2018**.

- International Balkan Conference in Sport Sciences – IBCSS, University of Tetova, Faculty of Physical Education, Tetova **2019**.

Punimet Shkencore për vitet akademike 2016-2019 nga mësimdhënësit pranë Fakultetit të Kulturës Fizike janë të paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Prof. Dr. Fadil Mamuti

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
J. Nebiu F. Mamuti	2016	Relations Between Anthropometric and Motoric Dimensios of the Pupils in Prishtina and Dragash.	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	Vol. 3/No. 5/6, pp. 1-95, pg. 33-36, Tetova, Macedonia
F. Mamuti P. Salihu J. Nebiu A. Bahtiri	2016	Learning and Assessment of Cartweel. Educational Gymnastics.	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	Vol. 3 / No. 5/6, pp. 1-95, pg. 40-45, Tetova, Macedonia
F. Mamuti	2017	Learning and Assessment of Gymnastics Bridge.	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	Vol. 4 / No. 7/8, pp. 1-95, pg. 43-46, Tetova, Macedonia
F. Mamuti F. Rexhepi	2018	Kinematic Analysis of Handstand in Gymnastics.	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	Vol. 5 / No. 9/10, pp. 1-154, pg. 85-91, Tetova, Macedonia
F. Mamuti	2019	Transition of Physical Education from Traditional to Modern System, Based on the	International Journal of Sport Sciences and	Vol. 6 / No. 11/12, pp. 1-101, pg. 54-62, Tetova, Macedonia

14

Fakulteti i Kulturës Fizike-Факултет за физичка култура-Faculty of Physical Education

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: pe@unite.edu.mk

		European Credit Transfer System (ECTS).	Health, Sport and Health	
F. Mamuti	2020	The Impact of globalization on education and dilemmas between traditional and modern education.	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health,	Vol. 7 / No. 13/14, pp. 1-70, pg. 27-32, Tetova, Macedonia

Doc. Dr. Astrit Iseni

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
A. Iseni I. Asllani A. Nuhiu	2016	Impact of functional skills on the performance of sprint running.	Activities in Physical Education and Sport, (Skopje),	vol.6,no.1, pp. 82-85.
A. Iseni, G. Hiseini, R. Bilalli	2016	Effects of Specific Motor Skills Agility with Students aged 13,.	Research in Kinesiology (Skopje),	vol.44,no.1, pp.81-85.
A. Simeonov Z. Radic A. Rakovic A. Iseni	2016	Comparative analysis and structure of the morphological basic and specific motor structure of the students in their second year of studies at the Faculty of Physical Education in the Discipline of Shot Put/	Research in physical education, sport and health, (Skopje),	vol.5, no. 2, pp. 107-110.
Z. Radic A.Simeonov A.Iseni A. Rakovic	2016	Biomechanical and kinematic analysis of spire throwing performed by the macedonian record holder Dejan Angelovski.	Acta Kinesiologica, (Sarajevo-Bosna and Hercegovina),	vol.10, no.1, pp. 38-43.
A. Iseni I. Asllani B.Sulejmani	2017	The Structure and specific motor skills of students from 14 years old, activities in physical.	Education and Sport, (Skopje)	vol. 7, no. 1 , pp. 24-26.

R. Bilalli				
Isa Asllani A. Iseni, M.Kamberi R. Bilalli	2017	The Influence and relationship of anthropometric features and motor abilities of sprint running in 60-100 meters of 16 years old students	Research in Kinesiology, (Skopje)	vol. 45, no. 1, pp. 14-16.
B. Sulejmani A. Iseni Z. Radic I. Asllani	2018	Canonical correlation between some basic motor and specific motor capacities of elementary school pupils.	Research in Kinesiology, 2018 (Skopje)	vol. 46, no.1-2, pp.39-41.
A. Kryeziu B. Begu I. Asllani A. Iseni	2019	Effects of the 4 week plyometric training program on explosive strength and agility for basketball players	Turk J Kinesiology, (Istanbul-Turkey)	5 (3): 110-116.
A. Iseni I. Asllani	2019	Impact of some anthropometric characteristics on the success of sprinter runs of 30, 80 and 100 meters in 14 years old students	Research in Kinesiology, (Skople)	vol.47, no. 1-2, pp. 13-15.

Doc. Dr. Kastriot Shaqiri

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
D. Kelmendi H. Ismaili N. Myrtaj A.Turijaka	2017	Physical activity and health	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	UDC:796-613-7 ISSN:1857-9310 (Print) Vol.4/No. 7-8, pp 30-35.
B. Sulejmani	201	The impact of some	International Journal	UDC:796-

16

Fakulteti i Kulturës Fizike-Факултет за физичка култура-Faculty of Physical Education

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: pe@unite.edu.mk

V. Ameti K. Shaqiri V. Ganiu, D. Dehari	8	morphological characteristics in karate	of Sport Sciences and Health, Sport and Health.	613-7 ISSN:1857-9310 (Print) Vol.4/No. 7-8, pp 17-21.
D.Kelmendi N. Myrtaj K. Shakiri	201 8	Measure characteristics of precision tests with top basketball players from Kosovo	Sport Science	11 (2018) 1: 89-91
Y. Rexhepi K. Shaqiri A. Ademi H. Ismaili B. Sulejmani	201 9	Differences in the anthropometric dimensions between karate and non athletes at the age of 16-18 years	6th International Balkan Conference in Sports Science, Tetova, Republic of N. Macedonia.	ISBN 978-608-217-078-7
B. Sulejmani A. Ademi D. Dehari, K. Shaqiri	201 9	Latent structure of motor abilities in karate	Sport Science 12 International scientific Journal of Kinesiology (2019) Suppl.	1: 121-125. e-ISSN: 1840-3670 p-ISSN:1840-3662, UDK:796

Doc. Dr. Laureta Abazi

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
K. Asani B.Telai L. Abazi N. Lenjani	2016	Analizë ndërlidhëse e variablave për vlerësim të hapësirës specifike motorike të frekuencës së lëvizjes tek anëtarët e reprezentacionit së karatesë së Maqedonisë	2 nd International Scientific Conference International Journal of Reserche in physical Education, Sport and Health.	2;121-123, Shkup.
L. Abazi J.Milenkovski B. Telai V. Zivkovic		Somatotype, size and body composition of competitive female vollebyball players	Research in Physical Education, Sport and Health,	Vol. 6, No. 2, pp.31-37, Shkup.
F. Ademaj N. Lenjanu A. Koleci L. Abazi	2018	Gender differences in antropometric measures of hanball players classified in the competition category cadets	Research in Physical Education, Sport and Health	Vol. 7, No. 2, pp.67-71, Shkup.

Doc. Dr. Agim Rexhepi

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
S. Gontarev R. Kalac V. Zivkovic V. Ameti A. Redjepi	2016	Anthropometrikcal Characteristics and Somatotype of Young Macedonian Soccer Players.	Intenacional. Journal Morphology Impact	(IF – 0.318) 2014-15.
S. Gontarev R. Kalac V.Ameti A. Redjepi		Factors Associated with Physical Activity among Macedonian Adolescnts in Albanian Ethnic Community	Iranian Jurnal of Public Health	Impact Factor (IF – 0.550), Vol. 45, No.4, Apr, pp. 474-484

Prof. Dr. Hyjnor Kica

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
H. Kica	2016	Preventive exercises for reinforcement collateral ligament knee in athletes performed at the sports ground	Journal of Macedonian association of Physiologist Anthropologists Physioacta	Vol. 10, No.2 pp. 97-104, Skopje.
H. Kica	2016	Nutrition immediately after exercise	Sport and Health,	Vol. 3, N0. 5-6, Tetova.
H. Kica	2016	Five week rehabilitation exercises with acceleration and deceleration for recovery and strengthening of knee cross ligaments after injury	FINA – World Sports edicine Congres, British Journal of Sports Medicine, Br J Sports	Med, 50: A 60 doi: 10.1136/bjs sports – 2016, 097120,105, Ljubljana.
H. Kica	2018	Differences of some anthropometric and motoric characteristics between 1 years of urban and rural areas	Sport and Healt	Vol. 5, N0. 9-10, pp. 149-54, Tetova.
H. Kica	2019	Probiotics in sportive nutritional practice: therapeutic and or preventive supplementary funds	Journal of Macedonian Association of Physiologists and Anthropologists	Vol. 13, No. 1, pp.27-37, Skopje.

Autori	Viti	Tema	Revista	Vëllimi/Faqet
D. Kelmendi H. Ismaili N. Myrtaj Kastriot Shaqiri, Arbëresha	2017	Physical activity and health	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health	I.UDC:796-613-7 ISSN:1857-9310 (Print) Vol.4/No. 7-8, pp 30-35

Turijaka				
B. Sulejmani V. Ameti K. Shaqiri V. Ganu D. Dehari	2017	The impact of some porphological characteristics in karate	International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health.	UDC:796-613-7 ISSN:1857-9310 (Print) Vol.4/No. 7-8, pp 17-21
D. Kelmendi N. Myrtaj K. Shaqiri	2018	Measure characteristics of precision tests with top basketball players from Kosovo	Sport science	1:89-91
Y. Rexhepi K. Shaqiri A. Ademi H. Ismaili B. Sulejmani	2019	Differences in the anthropometric dimensions between karata and non thletes at the age of 16-18	6 th International Balkan Conference in Sports Science	15-17 May, Tetova, Republic of North Macedenia. ISBN 978-608-217-078-7
B. Sulejamni A. Ademi D. Dehari K. Shaqiri	2019	Latent Stucture of motor abilities in karate		Sport Science 12 International sciencifi journal of kinesiology

6. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Fakulteti i Kulturës Fizike për realizim të mësimit praktik, prej 24.08.2015 shfrytëzon sallën sportive dhe dhjetë terrene të hapura sportive në UT dhe pishinën olimpike në Shkup. Në tabelat 8 dhe 9 janë pasqyruar të dhënat për hapësirat dhe pajisjet që i shfrytëzon Fakulteti i Kulturës Fizike.

Tabela 8. Hapësirat e UT-së, që i shërbejnë Fakultetit të Kulturës Fizike për realizim të procesit mësimor-shkencor

	Hapësira	Numri	M2	Numri i ulëseve
1	Objekte	1	/	/

2	Amfiteatër	1	174	170
3	Klasa	6	400	/
4	Salla konferencash	1	50	/
5	Laboratorë	1	50	/
6	Laboratorë për eksperimente	1	50	/
7	Laboratorë për hulumtime	1	50	/
9	Zyra të kuadrit	8	350	/
10	Zyra të administratës	1	64	/
11	Zyrat e udhëheqësve	5	80	/

Tabela 9. Pajisjet që i shërbejnë Fakultetit të Kulturës Fizike

	Pajisje	Për studentë	Për kuadrin mësimor	Për administratën	Biblioteka	Gjithsej
1	Kompjutorë	/	3	3	/	6
2	Internet	po	po	po	po	po
3	LCD Proektorë	/	3	/	/	3
4	Skenerë	/	3	/	/	3
5	Printer	/	4	/	/	4

7. SWOT ANALIZA

SWOT analiza në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike është përdorur si një kornizë për identifikimin dhe analizën e faktorëve të brendshëm (fuqive dhe dobësive) dhe faktorëve të jashtëm (mundësive dhe kërcënimeve) që ndikojnë në funksionimin e suksesshëm të tij. Identifikimi i komponentëve të jashtëm dhe të brendshëm të SWOT analizës luan një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e përgjithshme të procesit mësimor-shkencor dhe sukseseve që planifikohen të arrihen në të ardhmen.

Në vazhdim është e paraqitur tabela nga rezultatet e vetevaluimit sipas SWOT analizës në Fakultetin e Kulturës Fizike:

Tabela 10. SWOT analiza në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike

Strengths: Fuqitë	Opportunities: Mundësitë
<ul style="list-style-type: none">• Ofrim i programeve cilësore të arsimit të lartë dhe shkencës;• Përmirësim i mësimdhënies përmes përdorimit të metodologjive të reja;• Kultivimi i një mjedisi të hapur ku mundësohet të menduarit kritik dhe kreativ;• Kompatibilitet i programeve studimore me programet e Universiteteve me renome botërore; Infrastrukturë e përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese;• Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative;	<ul style="list-style-type: none">• Numër i madh i mësimdhënësve me kualifikime dhe referenca të larta;• Botimi i revistave shkencore;• Rritja e numrit të pajisjeve teknologjike (kompjuterë, printerë dhe projektorë)• Aftësim i kuadrin mësimor-shkencor për realizimin e projekteve shkencore-hulumtuese dhe aplikuese;• Mundësi e angazhimit plotësues të bashkëpunëtorëve;• Pjesëmarrje në nivel të kënaqshëm në projekte shkencore.

<ul style="list-style-type: none"> • Avancim i vazhdueshëm i stafit akademik; • Komunikim efektiv pedagog-student; • Transparencë dhe objektivitet në kontrollin e dijeve. 	
Weaknesses: Dobësitë	Threats: Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e kualifikimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit akademik; • Mungesë e rrjetit Alumni për ndjekjen e zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar; • Mungesa e mjeteve financiare për avancimin e projekteve mësimore-shkencore; • Shfrytëzim i pamjaftueshëm i fondeve ndërkombëtare për projekte shkencore-hulumtuese. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësimin e studentëve nga faktorë të jashtëm; • Shkallë e lartë e migracionit dhe gjendja e vështirë ekonomike në shoqëri ka ndikuar në uljen e numrit të studentëve; • Mundësi të kufizuara për punësim të studentëve të diplomuar.

8. KONKLUDIMI

Konkludimi përfshin përmbledhjen e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT ANALIZA) si dhe ofron planin aksionar specifik për të kompensuar dobësitë si dhe për të zhvilluar fuqitë e fakultetit në të ardhmen. Për më tej, me qëllim të rritjes së informimit të studentëve për të gjitha çështjet e lartpërmendura sugjerohet që:

- Informimi për pjesëmarrje në konferenca, projekte, mysafir ligjërues të realizohet jo vetëm përmes profesorëve por edhe prej burimeve tjera të cilat i përdorin shpesh

studentët si: tabela, ueb faqja, referentët dhe burime të ngjashme;

- Të përgatiten informatorë me të dhëna rreth programit studimor (lëndë - obligative, zgjedhore, kredi etj.) dhe t'ju dorëzohet çdo studenti të vitit të parë;
- Takim/broshurë/fletushkë për informim për procesin e përgatitjes së diplomës për vitet e katërta;
- Krijim i planit të koordinatorit për ECTS, - më së paku çdo fillim të vitit akademik me çdo vit studimor e veçanërisht me studentët e vitit të parë të realizohet takime për të prezantuar rolin dhe funksionin e koordinatorit si dhe sistemin e kredive;
- Vendosja e një kutie në hapësirat e Fakultetit të Kulturës Fizike ku studentët në formë të shkruar dhe anonime do të mund të parashtrojnë kërkesa, sugjerime, ankesa etj. .
- Të krijohet organogram dhe i njëjti të vendoset në një vend më frekuentues në fakultet;
- Stimulim i referentëve për dhënie të informatave të qarta.

Komisioni për Evaluim i Fakultetit të Kulturës Fizike

Prof. Dr. Hyjnor Kica - Kryetar

Prof. Dr. Fadil Mamuti - anëtar

Prof. Dr. Fadil Rexhepi -anëtar

Doc. Dr. Kastriot Shaqiri - anëtar

Doc.Dr. Agim Rexhepi - anëtar

Altina Ademi-anëtar - student

Ardit Memet -anëtar-student